



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.10.2023

Nr: 187

Ora: 13:30

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 33, DATË 19.10.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.10.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES:	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
OBJEKT:	Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Gëzim Topçiu, kryetar i bashkisë Maliq
BAZË LIGJORE:	Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Bashkia Maliq ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 25.3.2023, veprimtaritë publike me objekt si më poshtë:



1. "Takim pune nr. 1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan", raportuar datë 24.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.4.2023 ora 14:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Pojan".
 2. "Takim pune nr. 2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan", raportuar datë 24.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.4.2023 ora 16:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Pojan".
 3. "Inspektim punimesh nr. 1 në Njësinë Administrative Pojan", raportuar datë 24.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.4.2023 ora 11:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Pojan".
 4. "Inspektim punimesh nr. 2 në Njësinë Administrative Pojan", raportuar datë 24.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.4.2023 ora 12:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Pojan".
 5. "Kontroll punimesh në Njësinë Administrative Libonik", raportuar datë 25.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 29.4.2023 ora 16:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Libonik".
 6. "Takim pune me banorë të Njesisë Administrative Gore, Moglicë", raportuar datë 25.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 29.4.2023 ora 10:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Moglice, Gore".
 7. "Inspektim punimesh në qytetin e Maliqit", raportuar datë 25.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 29.4.2023 ora 15:00, me vend të zhvillimit në "Maliq".
2. Me vendimin nr. 413, datë 25.4.2023, në përputhje me përcaktimet e nenit 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, është vendosur ndalimi i zhvillimit të veprimtarive publike, të planifikuara për tu zhvilluar sipas datave të raportimit nga institucioni.
 3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 25.4.2023, ka administruar 2 (dy) denoncime të ardhura nëpërmjet postës elektronike dhe nëpërmjet portalit të denoncimeve me nr. unik 12227, datë 26.4.2023, të regjistruara **me nr. 417 ID**, për zhvillimin e veprimtarive të ndaluara në bashkinë Maliq.
 4. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ, në përfundim të së cilit në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, ka arritur në konkluzionin se bashkia Maliq, ka zhvilluar aktivitetet e ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas planifikimit të raportuar edhe pse titullari i këtij institucioni, z. Gëzim Topçiu ka patur informacion mbi ndalimin nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pohuar edhe nga vetë përgjigja e subjektit. Lidhur me

natyrën e veprimtarisë së ndaluar vërehet se janë takime me banorë të një karakteri teknik dhe detyre funksionale, si dhe nuk evidentohet asnjë material zgjedhor i cili mund ta bënte këtë aktivitet një aktivitet elektorale.

5. Nëpërmjet vendimit nr. 795, datë 06.10.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur t'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, gjobë në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për z. Gëzim Topçiu, kryetar i bashkisë Maliq.
6. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë regjistruar me nr. 33, datë 19.10.2023, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë duke e mbështetur këtë propozim në nenin 171, pikat 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor.
7. KQZ caktoi me short anëtarin e KAS-it z. Elvis Çefa, relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 33, datë 19.10.2023 të Komisionerit. KAS në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më datë 26.10.2023, ora 13:30.
8. Seanca e datës 26.10.2023, u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Palët janë njoftuar rregullisht konform ligjit dhe nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit, por depozituan prapësime me shkrim nëpërmjet adresës elektronike në lidhje me ështjen objekt shqyrtimi.
9. Nëpërmjet e-mail të datës 25.10.2023, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Maliq, depoziton elektronikisht prapësimet në lidhje me shqyrtimin e kërkesës nr. 33, datë 19.10.2023, të Komisionerit depozituar në KAS, ku ndër të tjera bën me dije se, *"Në përgjigje të emailit tuaj, referuar Kërkesës ankimore nr. 33 (nr. 7241 prot., datë 19.10.2023) ju paraqesim pretendimet tona si më poshtë;*

*Referuar detyrimit që parashikon neni 92 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Bashkia Maliq ka respektuar detyrimin për të raportuar të gjitha veprimtaritë me karakter publik që janë planifikuar të zhvillohen në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Sipas Vendimit nr. 795 datë 06.10.2023 bazuar në denoncimin nr. 417 ID është marre vendimi se aktivitet e raportuara nga Bashkia Maliq konkretisht: **"Takim pune nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 14:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan", Takim pune nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 16:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",Inspektim punimesh nr.1 me***

banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 11:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan", Inspektim punimesh nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 12:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan", " janë aktivitete të ndaluara.

- *Së pari, theksojmë se referuar këtyre aktiviteteve të ndaluara ju kemi kthyer përgjigje me e-mail pranë KQZ, se këto takime nuk janë zhvilluar por është vazhduar me takimet elektorale në Njësi të ndryshme Administrative nga ana e titullarit të Bashkisë Maliq.*
- *Së dyti, këto veprimtari të ndaluara nga KQZ-ja nuk janë transmetuar apo pasqyruar në rubrikat e lajmeve apo ato rubrika që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione sipas ligjit për transmetuesin radioteleviziv (siç parashikon neni 92 i ligjit për Kodin Zgjedhor).*
- *Së treti, provat e paraqitura nga ana e subjektit denoncues se këto aktivitete janë publikuar në faqen e facebook- ut të titullarit nuk qëndrojnë, pasi ajo është një faqe personale e titullarit që publikon aktivitete, foto dhe informacione të ndryshme, të cilat nuk duhet të ngatërrohen me raportimet zyrtare pranë KQZ-së, pjesë e detyrimeve ligjore që parashikon Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Fotot e publikuara janë në vazhdimësi të takimeve elektorale që Kryetari i Bashkisë ka zhvilluar gjatë periudhës 30 ditore të fushatës zgjedhore dhe nuk i referohen aktiviteteve të raportuara apo të ndaluara pranë faqes zyrtare të KQZ-së.*

10. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi këto prova shkesore:

- Kërkesën nr. 33, datë 19.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Vendimin nr. 795, datë 06.10.2023, "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 417 id të z. Edmond Spaho ndaj z. Gëzim Topçiu kryetar i bashkisë Maliq për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023";
- Denoncimin nr. 417 ID, si dhe foto/prova bashkëlidhur;
- Raporti i monitorimit me Kod Unik raporti: 19408590
- Njoftimet/komunikimi nëpërmjet postës elektronike për zhvillimin e senacave dhe kërkesa për informacion me personat objekt hetimi;
- Prapësimet e depozituara elektronikisht, nga personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për bashkinë Maliq.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi:

1. Komisioneri ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kryetarit të Bashkisë Maliq z. Gëzim Topçiu, me shkakun se ka zhvilluar 4 takime publike në territorin e bashkisë, pavarësisht ndalimit të vendosur nga Komisioneri për zhvillimin e tyre.
2. Lidhur me faktet e çështjes, KAS-i vë re se hetimi administrativ i kryer nuk ka arritur të provojë se kryetari i bashkisë ka vepruar në kundërshtim me urdhërimin për ndalimin e veprimtarive. Kryetari i bashkisë ka pretenduar se nuk ka zhvilluar veprimtaritë e planifikuara publike, por ka zhvilluar veprimtari elektorale në të njëjtat njësi administrative, duke respektuar urdhërimin e Komisionerit. Ky pretendim është hedhur poshtë nga Komisioneri me dy argumenta thelbësore. Së pari, Komisioneri ka vlerësuar se veprimtaritë e denoncuara nuk duket të jenë veprimtari elektorale dhe, së dyti, fakti që ato përkojnë me kohën dhe vendin e veprimtarive të ndaluara i përfshin ato në kushtet e ndalimit.
3. KAS-i çmon se hetimi administrativ i kryer nuk ka prodhuar asnjë provë që të mbështesë konkluzionin se takimet e zhvilluara nuk kanë qenë të natyrës zgjedhore, sikurse nuk ka prodhuar asnjë provë se takimet përkojnë me ato të ndaluara. Konkluzionet janë nxjerrë vetëm bazuar në administrimin e fotove të publikuara në adresën personale të kryetarit të bashkisë Maliq, të cilat provojnë datën dhe orën e postimit, por jo domosdoshmërisht datën, orën, vendin e zhvillimit të veprimtarisë, rrethin e pjesëmarrësve dhe tematikën e aktivitetit. Minimalisht ka qenë detyrë e KQZ-së që të provonte pjesëmarrjen e personave përgjegjës të bashkisë në takim, ose të sipërmarrësve të punëve publike, për të mbështetur konkluzionin se veprimtaritë ishin veprimtari institucionale dhe jo elektorale.
4. KAS-i vë re se ndalimi i veprimtarive është bërë, sikurse rezulton nga provat shkresore të KQZ-së, për shkakun se ato janë raportuar jashtë afatit minimal 5 ditor për raportimin, jo për shkakun se ato mund të përbënin keqpërdorim të burimeve publike. Dy nga veprimtaritë e raportuara kanë pasur objekt inspektim punimesh, por administrata e KQZ-së nuk ka kryer asnjë hetim në drejtim të vërtetimit të faktik, nëse veprimtaritë janë kryer në kushtet e keqpërdorimit të burimeve

shtetërore, apo jo. KAS-i nuk mund t'a zhvillojë këtë hetim me mjetet e seancës për shqyrtimin e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', si dhe në nenin 172, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës nr. 33, datë 19.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

U shpall sot, më datë 26.10.2023.

Elvis	ÇEFA	-	Relator	(kundër)
Elvin	LAKO	-	Anëtar	
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar	
Koli	BELE	-	Anëtar	
Ledio	BRAHO	-	Anëtar	